



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1180/1 Prot.

Vlorë më, 17 . 05 2024

VENDIM

Nr. 25, datë 17.05.2024

PËR

**DISA SAKTËSIME NË RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE
DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 38, nenit 131, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 19 pika 1, gërma dh) të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Urdhërit të MAS nr. 101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", në zbatim të shkresës së MAS 1893/20, prot, date 10.05.2024, protokolluar pranë nesh me nr.1131, datë 13.05.2024, shkresës së Rektorit me nr.1157, prot, datë 15.05.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.05.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë disa saktësime në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, si më poshtë:

1. Pika 4 e nenit 3 ishte:

4. Çdo student i ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në Universitetin e Vlorës ka të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve drejtuese dhe të anëtarëve të Senatit Akademik.

Pika 4 e nenit 3 të riformulohet në këtë mënyrë:

4. Çdo student i ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, si edhe studentët që ndjekin programet e studimit me karakter profesional në Universitetin e Vlorës, kanë të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve drejtuese dhe të anëtarëve të Senatit Akademik.

2. Pika 5 e nenit 4 ishte:

5. Të drejtën për t'u zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues (rektor/ drejtues i njësisë kryesore/drejtues i njësisë bazë), e kanë edhe persona që nuk bëjnë pjesë në stafin akademik me kohë të plotë në njësitë kryesore të Universitetit të Vlorës, të cilët i plotësojnë kriteret e parashikuara nga dispozitat e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të UV-së dhe nga kjo rregullore për të konkurruar për atë post.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Pika 5 e nenit 4 riformulohet në këtë mënyrë:

5. Të drejtën për t'u zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues (rektor/ drejtues i njësisë kryesore) e kanë edhe personel akademik që nuk bëjnë pjesë në stafin akademik me kohë të plotë në njësitë kryesore të Universitetit të Vlorës, të cilët i plotësojnë kriteret e parashikuara nga dispozitat e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të UV-së si dhe nga kjo rregullore për të konkuruar për atë post.

3. Pika 6 e nenit 4 ishte:

6. Të drejtën për t'u zgjedhur si autoritet drejtues i Universitetit të Vlorës e ka çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë që nuk ka fituar në të njëjtin funksion dhe në të njëjtin institucion dy mandate të njëpasnjëshme ose të ndara, të fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar". Në kuptim të nenit 131, pika 3 të ligjit 80/2015, mandat i fituar konsiderohet çdo mandat që është fituar përmes një procesi zgjedhor, pavarësisht nga kohëzgjatja e tij.

Pika 6 e nenit 4 riformulohet në këtë mënyrë:

6. Të drejtën për t'u zgjedhur si autoritet drejtues i Universitetit të Vlorës e ka çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë që nuk ka fituar në të njëjtin funksion dhe në të njëjtin institucion dy mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara, të fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara sipas ligjit nr.80/2015. Në kuptim të nenit 131, pika 3 të ligjit 80/2015, mandat i fituar konsiderohet çdo mandat që është fituar përmes një procesi zgjedhor, pavarësisht nga kohëzgjatja e tij.

4. Pika 11 e nenit 4 ishte:

11. Kur asnjëri prej dy a më shumë kandidatëve në garë për postin e një autoriteti drejtues nuk arrin të sigurojë shumicën e votave të vlefshme, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendrike pas zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë. Nëse edhe pas raundit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk arrin të sigurojë shumicën, zgjedhja për autoritet drejtues bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve.

Pika 11 e nenit 4 riformulohet në këtë mënyrë:

11. Kur 2(dy) a më shumë kandidatë në garë për postin e një autoriteti drejtues kanë numër të barabartë votash të vlefshme por numër më të madh se kandidatët e tjerë, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendrike pas zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë. Nëse edhe pas raundit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk arrin të sigurojë vota të vlefshme, zgjedhja për autoritet drejtues bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

5. Në nenin 25, pika 1, shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

ç) kopje e noterizuar e dokumentit që vërteton titullin akademik ose gradën shkencore, për kandidatët që vijnë nga jashtë UV-së;

6. Pika 5 e nenit 34 ishte:

5. Në Qendrën e Votimit vendosen kuti votimi në numër të barabartë me numrin e autoriteteve drejtuese, rektor, drejtues i njësisë kryesore,/ drejtues i njësisë bazë për të cilat kryhet votimi në njësinë kryesore të UV-së dhe dy kuti për Senatin Akademik, një për anëtarët e Senatit nga personeli akademik dhe një për anëtarët e Senatit përfaqësues të studentëve.

Pika 5 e nenit 34 riformulohet me këtë përmbajtje:

5. Në Qendrën e Votimit vendosen 3 (tre) kuti votimi të veçanta për secilin autoritet drejtues (rektor / drejtues i njësisë kryesore / drejtues i njësisë bazë) për të cilët kryhet votimi në njësinë kryesore të UV-së dhe 2 (dy) kuti për Senatin Akademik nga të cilat 1 (një) për anëtarët e Senatit nga personeli akademik dhe 1 (një) për anëtarët e Senatit përfaqësues të studentëve.

2. Rregullorja e saktësuar përcillet në MAS dhe publikohet në faqen WEB të UV-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
PROF.ASOC.XHILIOLA AGARAJ(SHEHU)**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE

PËR
ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET
DREJTUESE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORE

Miratuar me Vendim Nr. 11, datë 21.03.2024 të Senatit Akademik të UV-së
Rishikuar me Vendim Nr. 19, datë 23.04.2024 të Senatit Akademik të UV-së
Rishikuar me Vendim Nr. 25, datë 17.05.2024 të Senatit Akademik të UV-së



KREU I

DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregulla për përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, vëzhgimin, fushatën elektorale, etikën elektorale dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatën Akademik në Universitetin e Vlorës, duke përfshirë:

- a) kushtet dhe afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve dhe fushatat zgjedhore;
- b) rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore;
- c) kriteret për hartimin e listës së zgjedhësve;
- d) procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, si dhe për shpalljen e rezultateve;
- e) procedurat për shqyrtimin e ankimimeve;
- f) administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit zgjedhor;
- g) kushtet dhe afatet për regjistrimin e vëzhguesve, të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 57, pika 7, “Autonomia e institucioneve të Arsimit të Lartë dhe liritë akademike janë të garantuara me ligj”, neni 45, pika 4, “Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”, ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë, nenin 131, pika 2 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe në Statutin e Universitetit të Vlorës.

Neni 3

Subjekti i rregullores

1. Subjekt i kësaj rregulloreje është Universiteti i Vlorës .
2. Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë i njëjësive kryesore në Universitetin e Vlorës ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë rregullore. Nuk e gëzon të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur anëtar i personelit akademik i punësuar gjatë muajit të procesit zgjedhor.



3. Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kanë mbushur moshën për pension, nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në organet drejtuese dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.
4. Çdo student i ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, si edhe studentët që ndjekin programet e studimit me karakter profesional në Universitetin e Vlorës, kanë të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve drejtuese dhe të anëtarëve të Senatit Akademik.
5. Çdo student ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë rregullore.

Neni 4

Parime të përgjithshme

1. Zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Vlorës janë periodike, çdo 4 vjet.
2. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore.
3. Çdo zgjedhës ka të drejtën e 1 (një) vote të vetme për zgjedhjen e çdonjërit prej autoriteteve ose anëtarëve të Senatit Akademik.
4. Si mjet identifikimi për të votuar pranohet dokumenti:
 - i. pasaporta,
 - ii. karta e identitetit.
5. Të drejtën për t’u zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues (rektor/ drejtues i njësisë kryesore) e kanë edhe personel akademik që nuk bëjnë pjesë në stafin akademik me kohë të plotë në njësitë kryesore të Universitetit të Vlorës, të cilët i plotësojnë kriteret e parashikuara nga dispozitat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të UV-së si dhe nga kjo rregullore për të konkuruar për atë post.
6. Të drejtën për t’u zgjedhur si autoritet drejtues i Universitetit të Vlorës e ka çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë që nuk ka fituar në të njëjtin funksion dhe në të njëjtin institucion dy mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara, të fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar” dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara sipas ligjit nr.80/2015. Në kuptim të nenit 131, pika 3 të ligjit 80/2015, mandat i fituar konsiderohet çdo mandat që është fituar përmes një procesi zgjedhor, pavarësisht nga kohëzgjatja e tij.
7. Çdo kandidat mund të konkurrojë vetëm për 1 (një) post autoriteti drejtues.
8. Çdo kandidat ka të drejtë të organizojë dhe zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij, pranë çdo njësie kryesore, pa çënuar procesin mësimor.
9. Shpallet i zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim, me përjashtim të kandidatëve të vetëm.



10. Kur kandidon një kandidat i vetëm ai shpallet fitues me jo më pak se 50 % plus 1 (një) të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim. Nëse kandidati i vetëm nuk arrin të fitojë një numër të tillë votash, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë. Kur edhe pas raundit të dytë kandidati i vetëm nuk siguron 50 % plus 1 (një) të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim, shpallen zgjedhje të reja.

11. Kur 2(dy) a më shumë kandidatë në garë për postin e një autoriteti drejtues kanë numër të barabartë votash të vlefshme por numër më të madh sesa kandidatët e tjerë, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendrike pas zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë. Nëse edhe pas raundit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk arrin të sigurojë vota të vlefshme, zgjedhja për autoritet drejtues bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve.

12. Në rast se për postin e një autoriteti drejtues nuk regjistrohet asnjë kandidat, si në rastin e kandidatit të vetëm, zgjedhjet për këtë post zhvillohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin për rektorin, si dhe me urdhër të rektorit për drejtuesin e njësisë kryesore dhe të njësisë bazë, jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e zgjedhjeve të shpallura. Zgjedhjet e përsëritura zhvillohen në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me këtë rregullore. Gjatë periudhës kur nuk ka drejtues të zgjedhur, për caktimin e drejtuesit të njësisë veprohet sipas rregullit të përcaktuar në nenin 39, pika 9, pika 10, pika 11 dhe në nenin 42, pika 9 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

13. Zgjedhjet jashtë radhe zhvillohen jo më vonë se një vit përpara përfundimit të periudhës 4-vjeçare pas zgjedhjeve të fundit.

14. Në rastin kur për anëtarë të Senatit Akademik konkurrojnë më shumë kandidatë sesa numri i mandateve të caktuara për njësinë kryesore përkatëse, fitues shpallen kandidatët që sigurojnë numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim. Për kandidatët që fitojnë numër të barabartë votash, zgjedhja për anëtar të Senatit Akademik bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, në prani të palëve të interesuara, përveç rastit kur palët janë dakordësuar midis tyre.

15. Në rastin kur mbeten vende vakante për anëtarë në Senatin Akademik, për arsye se numri i kandidatëve është më i vogël sesa numri i mandateve, në njësinë kryesore përkatëse zhvillohet një raund i dytë zgjedhjes, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendrike pas ditës së zgjedhjeve. Për këtë raund kanë të drejtë të regjistrohen edhe kandidatë të tjerë që i plotësojnë kriteret e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe kërkesat e kësaj rregulloreje.

16. Vëzhguesit e kandidatëve që vijnë nga personeli akademik duhet të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë, në UV. Vëzhguesit e kandidatëve që vijnë nga studentët duhet të jenë studentë të njësisë kryesore përkatëse.



Neni 5

Periudha zgjedhore dhe thirrja e zgjedhjeve

1. Zgjedhjet për autoritetet dhe Senatin Akademik në Universitetin e Vlorës zhvillohen në mënyrë periodike, çdo 4 (katër) vjet.
2. Data e fillimit të procesit zgjedhor dhe dita e zgjedhjeve caktohet nga ministri përgjegjës për arsimin.
3. Autoriteti më i lartë drejtues në Universitetin e Vlorës shpall ditën e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga ministri për zgjedhjen e autoriteteve dhe Senatin Akademik në UV.
4. Zgjedhjet e rradhës për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të UV-së zhvillohen në të njëjtën ditë.
5. Zgjedhjet jashtë radhe për autoritetet drejtuese thirren brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas përfundimit para kohe të mandatit të autoritetit përkatës, nëse pjesa e mbetur e mandatit është jo më pak se një vit.
6. Qendrat e votimit hapen në orën 08:00 dhe mbyllen në orën 16:00. Askush nuk mund të votojë pasi KZF (KQV) merr vendim për mbylljen e procesit të votimit. Nëse pas orës 16:00 KZF (KQV) vëren se ka ende votues në radhë, u mbledh atyre mjetet e identifikimit dhe u mundëson votimin.

KREU II

INSTITUCIONET PËR PËRGATITJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE

Neni 6

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ)

1. Zgjedhja e anëtarëve të KIZ-it është detyrë dhe përgjegjësi e Senatit Akademik të Universitetit të Vlorës. Senati Akademik zgjedh KIZ-in, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:
 - a) Senati Akademik i zgjedh anëtarët e KIZ-it me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij, nga lista e të vetëkandiduarve që regjistrohen në sekretarinë e Senatit, e cila ka detyrimin t'i pajisë kandidatët me vërtetimin e regjistrimit. Përfaqësimi dhe numri i anëtarëve të KIZ-it përcaktohet mbi bazën e numrit të njërive kryesore të Universitetit të Vlorës. Në çdo rast ai duhet të jetë numër tek dhe jo më i vogël se 5, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Nga Senati Akademik caktohet dhe sekretari i KIZ-it, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë këtij komisioni. Sekretari përzgjidhet nga lista e të vetëkandiduarve nga personeli i Universitetit të Vlorës.
 - b) Komisioni Institucional i Zgjedhjeve i ushtron funksionet e tij për një mandat 4- vjeçar. Mandati perfundon me zgjedhjen e KIZ-it te ri.
 - c) Anëtarët e KIZ-it shpërblehen për punën që bëjnë. Masa dhe mënyra e shpërblimit të tyre caktohet me vendim të Bordit të Administrimit të UV-së, në bazë të akteve ligjore në fuqi.
 - ç) Në rastin e largimit të një anëtari nga ky komision, zëvendësimi i tij kryhet si në pikën 1 të këtij neni.



d) KIZ-i konstituohet jo më vonë se katër ditë nga dita e zgjedhjes së anëtarëve të tij nga ana e Senatit Akademik.

e) Anëtari i KIZ-it nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në Senatin Akademik.

f) Në mbledhjen e tij të parë KIZ-i zgjedh me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij kryetarin. Rezultati i zgjedhjeve publikohet në të gjitha mjediset e institucionit dhe në faqen zyrtare elektronike të UV-së.

g) Gjatë periudhës zgjedhore KIZ-i mblidhet jo më pak se tri herë në javë. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga dy anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e KIZ-it janë të hapura edhe për kandidatët e vëzhguesit e tyre.

h) KIZ-i i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet e KIZ-it publikohen në këndet zgjedhore të Universitetit të Vlorës, si dhe në faqen zyrtare elektronike të Universitetit dhe fakulteteve, jo më vonë se 12 orë pas vendimmarrjes.

2. KIZ-i ka këto kompetenca:

a) Nxjerr udhëzime për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor në të gjitha njësitë e Universitetit të Vlorës.

b) Drejton dhe kontrollon të gjithë procesin zgjedhor.

c) Emëron anëtarët e Komisioneve të Zgjedhjeve të Fakulteteve, të vetëkandiduar në KIZ.

d) Akrediton vëzhguesit sipas kërkesave të palëve të parashikuara në këtë rregullore.

e) Vendos për numrin e qendrave të votimit për çdo njësi kryesore.

f) Miraton vulën për KIZ-in, KZF-në dhe KQV-në, të cilat prodhohen dhe administrohen sipas kuadrit ligjor në fuqi. Vulat do të administrohen nga sekretaria e KIZ-it dhe KZF-së.

g) Regjistron kandidatët për rektor dhe për anëtarë të Senatit Akademik.

h) Shpall rezultatin e zgjedhjeve për rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik.

i) Administron, gjykon dhe merr vendim për ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.

3. Mandati i anëtarit të KIZ-it ndërpritet në rastet kur:

a) cenon etikën zgjedhore;

b) vdes;

c) jep dorëheqjen nga detyra;

d) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;

e) me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rëndë veprimtarinë e KIZ-it dhe procesin zgjedhor;

f) Mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në tri mbledhje radhazi. Trajtimi i çështjes së ndërprerjes së mandatit të një anëtarit të KIZ-it në këtë rast, bëhet vetëm me kërkesën e të paktën dy anëtarëve të tij. KIZ-i merr vendim mbi këtë kërkesë, jo më vonë se 1 orë pas depozitimit të saj. Vendimin për ndërprerjen e mandatit e merr KIZ-i kur për të votojnë "Pro" jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendi i mbetur bosh plotësohet brenda tri ditëve prej Senatit Akademik.

4. Sekretari i KIZ-it përgatit materialet për çdo mbledhje të KIZ-it. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve në librin e procesverbaleve dhe për çdo rast



jep shpjegime për çështjet që i kërkohen. Procesverbali i mbledhjes duhet të firmoset nga anetarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari i KIZ-it është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KIZ-it.

5. Vendimet e KIZ-it firmosen prej të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe vulosen me vulën e KIZ-it. Çdo anëtar i KIZ-it krahas nënshkrimit të tij mund të deklarojë në vendim votën kundër.

6. Kandidatët për rektor kanë të drejtë të kenë përfaqësuesin e tyre pranë KIZ-it, si anëtar ex-officio, pa të drejtë vote, gjatë muajit zgjedhor.

Neni 7

Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete (KZF)

1. Vendimi për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete, merret nga KIZ-i, jo më vonë se 3 (tri) ditë kalendarike nga dita e formimit të tij. KIZ-i zgjedh anëtarët e KZF-së me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij, nga lista e kandidatëve që vetëkandidohen në sekretarinë e KIZ-it, e cila ka detyrimin t'i pajisë kandidatët me vërtetimin e regjistrimit.

2. Përfaqësimi dhe numri i anëtarëve të KZF-së përcaktohet mbi bazën e numrit të njësive bazë në njësinë kryesore përkatëse. Në çdo rast ai duhet të jetë numër tek dhe jo më i vogël se 3 anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Nga KIZ-i caktohet dhe sekretari i KZF-së, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë këtij komisioni. Sekretari përzgjidhet nga lista e të vetëkandiduarve nga personeli i njësisë kryesore të KZF-së përkatëse.

3. Anëtarët i KZF-së nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të cilitdo niveli.

4. Mbledhja e parë e KZF-së zhvillohet një ditë pas vendimit të KIZ-it për ngritjen e tij. Në këtë mbledhje zgjidhet, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KZF-së, kryetari. Rezultati i zgjedhjeve publikohet në mjediset ku zhvillon aktivitetin akademik njësia kryesore përkatëse, si dhe në faqen zyrtare elektronike të Universitetit.

5. KZF-ja mblidhet jo më pak se tri herë në javë. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga dy anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Në mbledhjet e KZF-së mund të jenë të pranishëm kandidatët ose vëzhguesit.

6. KZF-ja i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet e KZF-së publikohen në mjedisin e njësisë kryesore ku është vendosur selia e tij, si dhe në faqen zyrtare elektronike të Universitetit, jo më vonë se 12 orë pas marrjes së tyre.

KZF-ja ka këto kompetenca:

a) Përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në njësinë kryesore.

b) Kryen funksionet e Komisionit të Qendrës së Votimit për anëtarët e personelit akademik.

c) Emëron kryetarin dhe anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, kur, me vendim të KIZ-it, në njësinë kryesore votimi do të zhvillohet në më shumë se një qendër votimi.

d) Regjistron kandidatët për drejtues të njësisë kryesore dhe për drejtues të njësive bazë.



e) Publikon listën e zgjedhësve në mjediset e njësisë kryesore, pas miratimit përfundimtar të saj.

f) Shpall rezultatin e zgjedhjeve për drejtues të njësisë kryesore dhe për drejtues të njësive bazë dhe ia dërgon KIZ-it.

g) Nxjerr rezultatin e votimit për rektorin dhe për anëtarët e Senatit Akademik, të cilat i dërgon në KIZ.

h) Merr vendim brenda kompetencave të veta mbi ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.

7. Kandidatët për drejtues të njësive kryesore dhe drejtues të njësive bazë kanë të drejtë të kenë përfaqësuesit e tyre në KZF dhe KQV, si vëzhgues, të cilët akreditohen prej KIZ-it. Vëzhguesit duhet të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë.

8. Mandati i anëtarit të KZF-së ndërpritet në rastet kur:

a) cenon etikën zgjedhore;

b) vdes;

c) jep dorëheqjen nga detyra;

d) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;

e) me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rëndë veprimtarinë e KZF-së dhe procesin zgjedhor;

f) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në tri mbledhje radhazi. Shqyrtimi i çështjes së ndërprerjes së mandatit të një anëtari të KZF-së në këtë rast, bëhet vetëm me kërkesën e të paktën dy anëtarëve të tij, të cilët e paraqesin atë te KIZ-i. Vendimin për ndërprerjen e mandatit e merr KIZ-i, jo më vonë se 1 orë pas paraqitjes së kërkesës. Për të duhet të votojnë "Pro" jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendi bosh plotësohet brenda 2 ditëve prej KIZ-it.

9. Sekretari përgatit materialet për çdo mbledhje të KZF-së. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve në librin e procesverbalit dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kërkojnë. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KZF-së. Sekretari përzgjidhet nga lista e të vetëkandiduarve pjesë e personelit të njësisë kryesore. Vendimet e KZF-së firmosen prej të gjithë anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe vulosen me vulën e KZF-së.

10. Anëtarët e KZF-së shpërblehen për punën që bëjnë. Masa dhe mënyra e shpërblimit të tyre caktohet me vendim të Bordit të Administrimit të UV-së, në bazë të akteve ligjore në fuqi.

Neni 8 Qendrat e Votimit

Pranë çdo njësie kryesore caktohen Qendrat e Votimit nga KIZ-i. Si rregull, çdo qendër votimi ka deri në 1000 (një mijë) zgjedhës, të të gjitha trupave zgjedhore, përfshirë studentët. Në rast se njësia kryesore ka më shumë se 1000 (një mijë) zgjedhës, KIZ-i mund të caktojë më shumë se një qendër votimi për atë njësi kryesore.



Neni 9

Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV)

1. Në rastin kur procesi i votimit do të zhvillohet vetëm në një qendër votimi në njësinë kryesore, detyrat e komisionit të qendrës së votimit kryhen prej KZF-së. Kur KIZ-i ka vendosur ngritjen e më shumë se një qendre votimi në njësinë kryesore, KZF-ja ngre komisionet e qendrave të votimit (KQV).
2. KQV-ja përbëhet nga 3 anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e KQV-së emërohen prej KZF-së në bazë të vetëkandidimeve.
3. Vendimi për formimin e KQV-së merret prej KZF-së jo më vonë se tri ditë para ditës së votimit. Në këtë vendim caktohet edhe kryetari i KQV-së. Njëri prej anëtarëve kryen detyrat e sekretarit të KQV-së.
4. Anëtari i KQV-së nuk mund të kandidojë për asnjë post drejtues ose anëtar në Senatin Akademik.
5. Komisioni i Qendrës së Votimit ka për detyrë vetëm organizimin, zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të votimit ditën e zgjedhjeve. Në përfundim të këtij procesi, KQV-ja administron materialet zgjedhore, sipas procedurës dhe rregullave të përcaktuara në këtë rregullore dhe ia dorëzon ato KZF-së.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

1. Çdo kandidat/e i/e vetëkandiduar për autoritet drejtues dhe Senatin Akademik të UV ka të drejtë të caktojë 1(një) vëzhgues në KZF, KQV dhe për çdo tavolinë në vendin e numërimit të votave pas regjistrimit të kandidatit/es në procesin zgjedhor.
2. Organizata joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara dhe të angazhuara për mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësues të ministrisë së linjës ose të medias kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhjet e UV-së. Akreditimi i tyre ka të njëjtën procedurë si dhe ai vëzhguesve të kandidatëve konkurentë, anëtarë të stafeve akademike apo studentëve në UV. Ai bëhet mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi.
3. Në rastin e organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara dhe të angazhuara për mirëqeverisjen dhe demokratizimin, ato janë të detyruara të hartojnë një raport vlerësimi për procesin zgjedhor, 15 ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare.
4. Vëzhguesit, kandidatët dhe përfaqësuesit e tyre si vëzhgues, i ndalohet rreptësisht prishja e qetësisë, filmimi dhe bërja e fotografive gjatë procesit të votimit dhe numërimit. Në rast të shkeljes së këtyre standardeve etike, i tërhiqet vëmendja publikisht. Në rast përsëritjeje KIZ/KZF merr vendim për përjashtimin e tij/saj me shumicë votash.
- 4.1. Gjatë kryerjes së detyrës së tyre vëzhguesit kanë këto të drejta:
 - a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;



b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërehet;

c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.

4.2. Vëzhguesit kanë këto detyra:

a) të respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje dhe udhëzimet e KIZ-it për vëzhgimin e zgjedhjeve;

b) të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas kësaj rregulloreje;

c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KIZ-i, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KIZ-i;

d) të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësve;

e) të mos dhunojnë të drejtën e votuesve për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë aktivitetin e KZF-së/ KQV-së në procesin e votimit, të numërimit dhe administrimit të zgjedhjeve.

KREU III ZGJEDHËSIT DHE LISTA E ZGJEDHËSVE

Neni 11

Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve

1. Në zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të Universitetit të Vlorës marrin pjesë:

a) Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë i njëjësive kryesore në Universitetin e Vlorës ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë rregullore. Nuk e gëzon të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur anëtari i personelit akademik i punësuar gjatë muajit zgjedhor.

Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” që kanë mbushur moshën për pension, por vijojnë marrëdhënien e punës me UV-në, nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në organet drejtuese por bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.

Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 63 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, shkëputen për një periudhë deri në 1 (një) vit për vitin sabatik, por edhe ata që largohen për kualifikime vetjake me karakter mesimor kërkimor, siç parashikohet në nenin 48 të Statutit, nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në Senatit Akademik,



por gëzojnë të drejtën të zgjedhin autoritetet drejtuese ose Senatin Akademik, nëse periudhat e parshikuara me sipër perkojnë me muajin zgjedhor.

Çdo student i ciklit të parë, të dytë dhe të tretë si edhe studentët që ndjekin programet e studimit me karakter profesional në Universitetin e Vlorës ka të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve drejtuese dhe të anëtarëve të Senatit Akademik. Çdo student ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë rregullore.

2. Lista e zgjedhësve për personelin akademik hartohet për çdo njësi bazë sipas të dhënave të regjistrimit të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë, që administrohet nga Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore të Universitetit të Vlorës.

Çdo zgjedhës identifikohet me përbërësit zgjedhorë:

- a) Emri
- b) Atësia
- c) Mbiemri
- d) Datëlindja
- e) Gjinia
- f) Njësia bazë ku është i punësuar/programi mësimor që ndjek studentin.

3. Organ përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve për personelin akademik është Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore.

Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve është si më poshtë:

- a) Lista paraprake e zgjedhësve hartohet prej DKBNJ-se jo më vonë se 10 ditë nga shpallja e ditës së zgjedhjeve, e cila e përcjell pranë njësive kryesore përkatëse.
- b) Lista paraprake afishohet në mjediset e njësisë kryesore përkatëse.
- c) Gjatë një periudhe 5 (pesë) ditore pas shpalljes së listës paraprake, DKBNJ pranon kërkesat për korrigjime.
- d) Pas verifikimit të kërkesës, DKBNJ realizon korrigjimin e kërkuar brenda 48 orësh.
- e) Pas përfundimit të periudhës për korrigjimin e listës paraprake, DKBNJ harton listën përfundimtare e cila miratohet prej Rektorit. Lista e zgjedhësve afishohet në mjediset e njësisë kryesore. Një kopje e listës i dërgohet KIZ-it. Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe, prej DKBNJ dhe e vulosur me vulën e institucionit.
- f) KIZ-i kërkon pranë DKBNJ-së organigramën e institucionit në përputhje me Statutin e UV-sw dhe ndryshimet që ajo mund të ketë pësuar.

4. Organ përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve për studentët është sekretaria mësimore e njësisë kryesore. Lista përfundimtare miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve për studentët është si më poshtë:

- a) Lista paraprake e zgjedhësve për studentët e njësisë kryesore hartohet prej sekretarisë mësimore të njësisë kryesore jo më vonë se 10 ditë nga shpallja e ditës së zgjedhjeve.
- b) Lista paraprake afishohet në mjediset e njësisë kryesore.



c) Gjatë një periudhe deri në shtatë ditë pas shpalljes së listës paraprake, sekretaria mesimore pranon kërkesat për korrigjime.

d) Pas verifikimit të kërkesës, sekretaria realizon korrigjimin e kërkuar brenda 48 orësh.

e) Pas përfundimit të përiudhës për korrigjimin e listës, sekretaria harton listën përfundimtare e cila miratohet prej drejtuesit të njësisë kryesore. Lista e zgjedhësve për studentët afishohet në mjediset e njësisë kryesore. Një kopje e listës i dërgohet KIZ-it.

ë) Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe, prej drejtuesit të njësisë kryesore dhe e vulosur me vulën e njësisë kryesore.

5. Shtatë ditë përpara ditës së zgjedhjeve, lista përfundimtare e zgjedhësve për personelin akademik dhe për studentët nuk mund të korrigjohet për asnjë arsye. Pas kësaj periudhe, zgjedhësit që nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve ose kanë gabime në përbërësit zgjedhorë, mund të votojnë vetëm në rastin kur, pas shqyrtimit të kërkesës së tyre, KIZ vendos me vendim lidhur me kërkesat për të marrë pjesë në zgjedhje. Kërkesa të tilla, KIZ mund t'i shqyrtojë deri në dy ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Zgjedhësi i pajisur me vendimin e KIZ mund të votojë vetëm me paraqitjen e tij në Komisionin e Qendrës së Votimit.

6. E gjithë procedura për hartimin e listës së zgjedhësve për personelin akademik dhe studentët monitorohet prej KIZ. Për këtë qëllim, KIZ miraton një plan pune dhe cakton dy prej anëtarëve të tij për monitorimin e këtij procesi. Anëtarët përgjegjës raportojnë, në mënyrë periodike në KIZ, për ecurinë e procedurave për hartimin e listës së zgjedhësve.

Neni 12

Trupa zgjedhore për anëtarët e personelit akademik të Senatit Akademik

1) Trupa zgjedhore për Senatin Akademik të UV-së përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i të gjitha njësive kryesore.

2) Personel akademik me kohe të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Trupa zgjedhore për anëtarët studentë të Senatit Akademik

Trupa zgjedhore për anëtarët studentë të Senatit Akademik të UV-së përbëhet nga studentët që ndjekin studimet me kohë të plotë në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë, siç është përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Trupa zgjedhore për Rektorin

Trupa zgjedhore për rektorin e UV-së përbëhet nga:

a) personeli akademik me me kohe të plote i të gjitha njësive kryesore. Personel akademik me kohë të plotë do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.



b) studentët të përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje. Votat e studentëve në zgjedhjen e rektorit llogariten në masën 10 % (dhjetë per qind) të totalit të përgjithshëm të votave.

Neni 15

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë kryesore

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë kryesore përbëhet nga:

- a) personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore. Personel akademik me kohë të plotë do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.
- b) studentët, të përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje, në atë njësi kryesore. Votat e studentëve në zgjedhjen e drejtuesit të njësisë kryesore llogariten në masën 10 % (dhjetë për qind) të totalit të përgjithshëm të votave.

Neni 16

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë bazë

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë bazë përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë bazë. Personel akademik me kohë të plotë do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 17

Trupa zgjedhore për anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore

Trupa zgjedhore për anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar 3 të kësaj rregulloreje.

KREU IV

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE DHE FUSHATA ZGJEDHORE

Neni 18

Regjistrimi i kandidatëve

1. Procesi i regjistrimit të kandidatëve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë fillon ditën e shpalljes nga komisioni zgjedhor përkatës dhe përfundon në orën 16:00 të ditës së pestë kalendarike.
2. Dita për fillimin e regjistrimit të kandidatëve për rektor dhe për anëtar të Senatit Akademik të UV-së shpallet prej KIZ-it, 2 (dy) ditë kalendarike pas ditës së konstituimit të tij.
3. Dita për fillimin e procedurës për regjistrimin e kandidatëve për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, për anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore shpallet prej KZF-së dy ditë kalendarike pas ditës së konstituimit të tij.
4. Mosregjistrimi i kandidatëve bëhet me vendim të arsyetuar nga KIZ/KZF. Vendimi për mosregjistrimin e kandidatëve është i ankimueshëm pranë Komisionit të Apelit në UV.



5. Kandidatët e regjistruar pranë KIZ/KZF për autoritet drejtues në UV dhe Senat Akademik nuk mund të heqin dore nga kandidimi gjatë procesit zgjedhor.

Neni 19

Kriteret për anëtarët e Senatit Akademik

1. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 17 të Statutit të UV-së dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik, në UV i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të personelit akademik me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë dhe të përzgjidhen si anëtarë të Senatit edhe personel akademik që mban gradën shkencore “Doktor”.
 - 2.1 Për kandidatët më gradën “Doktor” të cilëve u lind e drejta të garojnë midis tyre si anëtar të Senatit Akademik, votohet në një fletë të veçant ndërmjet tyre.
3. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik në UV, përfaqësues të studentëve, i përkasin kategorisë student të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. Kandidatët duhet të kenë mesataren mbi 8 (tetë). Në rastet kur një student i zgjedhur në Senatin Akademik përfundon studimet universitare ose humbet statusin e studentit, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje, për nga numri i votave të grumbulluara, në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur. Nëse nuk ka studentë të mbetur në listë, zhvillohen përsëri zgjedhjet, siç parashikohet në këtë rregullore.
4. Nuk mund të kandidojnë për anëtar të Senatit Akademik anëtarët e personelit akademik ose studentët që:
 - a) janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë një masë e sigurimit personal;
 - b) janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) janë të dënuar më parë për vepra penale;
 - ç) ndaj tyre është dhënë masë disiplinore
 - d) nuk dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it) i cili përmban deklaratimet:
 - i. për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
 - ii. për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, ligji nr. 138/2015.



Neni 20

Kriteret për rektor të UV-së

1. Kandidatët për rektor të UV-së duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 39 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 30 të Statutit dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për rektor të UV-së duhet të mbajnë titullin “Profesor” dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë të UV-së ose jashtë tij. Kandidatët për rektor vetëkandidohen dhe duhet të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
3. Nuk mund të kandidojnë për rektor të UV-së personat që:
 - a) janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë një masë e sigurimit personal;
 - b) janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) janë të dënuar më parë për vepra penale;
 - ç) ndaj tyre është dhënë masë disiplinore
 - d) kanë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 (“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”) dhe ligjit nr. 138/2015 (“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”);
 - e) nuk dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it) i cili përmban deklaratimet:
 - i. për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
 - ii. për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, ligji nr. 138/2015;
 - f) kanë qenë rektorë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, llogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes.
 - g) kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015.
 - h) kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Neni 21

Kriteret për drejtues të njësisë kryesore

1. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në UV duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 43 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 34 të Statutit të UV-së dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në UV i përkasin kategorisë “Profesor” dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë të UV-së ose jashtë tij. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore vetëkandidohen dhe duhet të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;



3. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë kryesore në UV personat që:
- a) janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë një masë e sigurimit personal;
 - b) janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) janë të dënuar më parë për vepra penale;
 - ç) ndaj tyre është dhënë masë disiplinore;
 - d) kanë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 (“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”) dhe ligjit nr. 138/2015 (“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”);
 - e) nuk dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit (i cili mund të tërhiqen pranë KZF-së) i cili përmban deklaratimet:
 - i. për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
 - ii. për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ligji nr. 138/2015;
 - f) kanë qenë drejtues të njësisë kryesore të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara, në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, llogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes;
 - g) kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015;
 - h) kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Neni 22

Kriteret për drejtues të njësisë bazë

1. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë në UV duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 45 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 38 të Statutit të UV-së dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë në UV janë personel akademik me kohë të plotë të njësisë bazë që i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë vetëkandidohen dhe duhet të kenë përvojë në mësimdhënie për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet dhe të jenë pjesë e personelit akademik.
3. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë bazë në UV kandidatët që:
 - a) janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë një masë e sigurimit personal;
 - b) janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) janë të dënuar më parë për vepra penale;
 - ç) ndaj tyre është dhënë masë disiplinore



d) kanë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 ("Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë") dhe ligjit nr. 138/2015 ("Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike");

e) nuk dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KZF-së) i cili përmban deklaratimet:

- i. për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
- ii. për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, ligji nr. 138/2015;

f) kanë qenë drejtues të njësisë bazë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara, në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, llogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes;

g) kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015;

h) kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Neni 23

Kriteret për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore

1. Kandidatët për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

2. Numri i komisioneve dhe vendeve për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore në UV, janë përcaktuar në Nenin 22 "Komisionet e përhershme" të Statutit.

3. Kandidatët për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore, vijnë nga radhët e personelit akademik.

4. Nuk mund të kandidojnë për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, kandidatët që:

- a) janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
- b) janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formes se prerë;
- c) janë të dënuar me parë për vepra penale;
- d) ndaj tyre është dhënë masë disiplinore

Neni 24

Kandidimi

1. Kandidatët për autoritete drejtuese të të gjitha niveleve, për Senatin Akademik dhe komisionet e përhershme, vetëkandidohen.

2. Kandidatët për Senatin Akademik, përfaqësues të studentëve, të cilët plotësojnë kriteret e nenit 19, pika 3, të kësaj rregulloreje, propozohen nga jo më pak se 30 studentë, pjesë e



trupës zgjedhore, të cilët mbështesin vetëm një kandidat. Në fletën që dëshmon për mbështetjen nga 50 studentë, duhet të jenë pasqyruar emri, mbiemri, mjeti i identifikimit si dhe fakulteti/dega nga vjen studenti.

3. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të UV-së dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 25

Dokumentacioni për kandidim

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët dorëzohet në KIZ (për kandidatët për rektor dhe anëtar të Senatit Akademik) dhe në KZF (për kandidatët për drejtues të njësisë kryesore dhe bazë), i cili përmban:

a) kërkesën për kandidim, e cila përmban emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë, dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;

b) kopje të dokumentit të identifikimit;

c) Formularin e vetëdeklarimit sipas aneksit 1 dhe 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ ose KZF për çdo rast) i cili përmban:

i. deklarimin se kandidati që kandidon për autoritet drejtues të çdo niveli, nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;

ii. deklarimin për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;

iii. deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

iv. deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;

ç) kopje e noterizuar e dokumentit që vërteton titullin akademik ose gradën shkencore, për kandidatët që vijnë nga jashtë UV-së;

2. KIZ-i dhe KZF-të për të gjithë kandidatët duhet të kërkojë pranë DKBNJ-së kopje të noterizuar të titullit akademik më të lartë.

3 KIZ-i dhe KZF-të për të gjithë kandidatët duhet të kërkojë pranë DKBNJ-së informacion nëse ndaj kandidatit është dhënë masë disiplinore.

4. Dokumentet e kandidimit për studentët dorëzohen në KIZ dhe përmbajnë:

a) kërkesën për kandidim, e cila përfshin, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;

b) kopje të dokumentit të identifikimit;

c) Vërtetimin që provon se është student me kohë të plotë në një nga njësitë kryesore në UV;



d) propozimin nga jo më pak se 30 studentë pjesë e trupës zgjedhore, sipas standardeve të parashikuara në kete rregullore, të cilët krahas emrit, mbiemrit dhe nenshkrimit vendosin në shkresën e propozimit edhe numrin personal të kartës së identitetit;

e) dokumentin që vërteton mesataren e notës mbi bazën e provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit.

3. Pas verifikimit të dokumentacionit KIZ-i, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidatëve për rektor dhe të kandidatëve për Senatën Akademik. Listat shpallen publikisht në mjediset e institucionit dhe në faqet zyrtare elektronike të UV-së.

4. Pas verifikimit të dokumentacionit KZF, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidatëve për drejtues, të njësive kryesore, si dhe listën e kandidatëve për drejtues të njësive bazë, të komisioneve të përherëshme si dhe listën e kandidatëve për anëtar të Senatit Akademik.

5. Pas regjistrimit çdo kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat prej komisionit zgjedhor që kryen regjistrimin e tij. Forma e këtij vërtetimi miratohet me vendim të KIZ-it.

Neni 26

Kohëzgjatja e mandateve

1. Autoritetet drejtuese dhe anëtarët e Senatit Akademik të UV-së zgjidhen për një mandat 4-vjeçar.
2. Komisionet e përherëshme të njësive kryesore zgjidhen për një mandat 2-vjeçar
3. Mandati i anëtarëve të KIZ-it/KZF-së dhe Komisionit të Apelit është 4-vjeçar.
4. Rastet e ndërprerjes së mandateve përcaktohen në kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 27

Përfaqësimi i njësive kryesore në Senatën Akademik

Bazuar në nenet 33 e 37 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe në nenin 17 të statutit të UV-së, Senati Akademik i UV-së përbëhet nga 23 anëtar.

Numri i përfaqësuesve për studentët në Senatën Akademik duhet të jetë në masën 10 %.

Neni 28

Fushata zgjedhore

1. Fushata zgjedhore fillon në datën e përcaktuar nga urdhri i autoritetit përkatës (ministri, rektori).
2. Fushata zgjedhore përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore.



3. Administratori dhe administrata e UV-së duhet t'u krijojë kushte të përshtatshme dhe te barabarta të gjithë kandidatëve për të zhvilluar aktivitetet e tyre në kuader të tushatës elektorale. Në përputhje me kërkesën e kandidatit, bashkërenduar edhe me kalendarin e miratuar nga KIZ/KZF për kohën dhe vendin për zhvillimin e aktivitetit, administrata e institucionit merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e tij, jashtë orëve të mësimit që zhvillohen në institucion.

KREU V PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR

Neni 29


Vendndodhja e komisioneve zgjedhore dhe e vendeve të numërimit të votive

1. Vendndodhja e komisioneve zgjedhore përcaktohet sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a) Zyra e KIZ-it vendoset në godinën ku ndodhet administrata qendrore e UV-së.
 - b) Zyra e KZF-së vendoset në godinën ku zhvillon aktivitetin mësimor ose kërkimor njësia kryesore.
2. Vendet e numërimit të votave përcaktohen sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a) Votat për rektorin, drejtuesin e njësisë kryesore, drejtuesin e njësisë bazë për anëtar të Senatit Akademik, anëtar të Komisioneve të Përherëshme numërohen në një ambient të caktuar në godinën ku zhvillon aktivitetin mësimor ose kërkimor njësia kryesore.
 - b) Ambienti i numërimit të votave duhet të ketë përmasa të atilla që të krijojnë mundësi për procesin e numërimit të votave. Organizimi i ambientit për numërimin votave duhet t'u japë mundësi kandidatëve dhe vëzhguesve të tyre për të qenë të pranishëm, gjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave.

Neni 30

Komisionet për vlerësimin dhe numërimin e votave

1. Votat për rektor, anëtar të Senatit Akademik, drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, dhe për anëtar të Komisioneve të Përherëshme vlerësohen dhe numërohen prej KZF-së.
2. KZF-ja, pas numërimit të votave, sipas radhës së përcaktuar në nenin 35 plotëson tabelat zgjedhore për secilën kategori dhe ia përcjell KIZ-it, brenda 24 orëve nga ora e mbylljes së procesit të votimit.
3. KIZ-i, pas plotësimit të afateve për ankimimin, shpall fituesit, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.



Neni 31

Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor

1. Në zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të UV-së personeli akademik voton me katër fletë të dallueshme nga njëra-tjetra:
 - a) fletëvotimi për rektor;
 - b) fletëvotimi për drejtues të njësisë kryesore;
 - c) fletëvotimi për drejtues të njësisë bazë;
 - ç) fletëvotimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik.
 - d) fletëvotimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik që mban gradën shkencore "Doktor.
 - e) fletëvotimi për komisionet e përherëshme nga personeli akademik.
2. Në zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik studentët votojnë me tri fletëvotimi të dallueshme nga njëra-tjetra:
 - a) fletëvotimi për rektor;
 - b) fletëvotimi për drejtues të njësisë kryesore;
 - c) fletëvotimi për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve;
 - ç) fletëvotimi për anëtar të komisionet e përherëshme, përfaqësues i studentëve;
3. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve sipas listës përfundimtare, duke i shtuar 2 % (dy për qind).
4. Standardet e fletës së votimit hartohen dhe miratohen nga KIZ-i. Duhet të jetë prej letre, me ngjyrë dhe trashësi që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të saj. Fletët e votimit prodhohen në blloqe pa kundërfletë me numër serial unik. Informacioni që përmban fleta e votimit është:
 - a) në krye të fletës së votimit vendoset emërtesa për të cilën do të përdoret;
 - b) emërtimi i autoritetit drejtues ose Senati Akademik;
 - c) emri, atësia, mbiemri për kandidatët e regjistruar për autoritetin drejtues ose Senatit Akademik përkatës pasqyrojnë të dhënat e kandidatit në mjetin e identifikimit zyrtar. Kandidatët renditen sipas rendit alfabetik;
 - d) në fletën e votimit për autoritetet drejtuese dhe anëtar për Senatit Akademik, zgjedhësi vendos në krah të emrit të kandidatit vetëm këto tri shenja "x" "+" "√". Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri.
 - e) në rastin kur për autoritetin drejtues ose anëtar të Senatit Akademik është regjistruar dhe konkurren vetëm një kandidat, në fletën e votimit krahas emrit të tij vendosen alterantivat për votim "Pro" ose "Kundër";
 - f) fleta e votimit për studentët në sfond të saj ka të shkruar "Për student".

Neni 32

Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KIZ në KZF

1. Një ditë përpara datës së zgjedhjeve KIZ-i dërgon në KZF materialet zgjedhore, si më poshtë:



- a) fletët e votimit për personelin akademik dhe për studentët, sipas nenit 29, pika 3, të kesaj rregulloreje.
 - b) listën përfundimtare të zgjedhësve për personelin akademik dhe listën e zgjedhësve për studentët, të vulosura nga KIZ-i;
 - c) vulën e KZF-së;
 - d) vulat e KQV-ve, në rast se në njësinë kryesore do të ketë më shumë se një qendër votimi.
 - e) procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë: procesverbalet për kodet e sigurisë së kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, si dhe mbylljen e votimit;
 - f) zarfin në të cilin është shënuar “Fletë votimi të dëmtuara”;
 - g) zarfin në të cilin është shënuar “Fletë votimi të papërdorura”;
 - h) zarfin në të cilin është shënuar “Zarfi i procesverbalit të vulosjes”;
 - i) zarfin në të cilin është shënuar “Zarfi i fletëve të votimit të hedhura në kutinë e gabuar”.
2. Përveç kutisë me materiale zgjedhore, në KZF dërgohen edhe kutitë e votimit:
- a) kutia e votimit për rektor;
 - b) kutia e votimit për dekan/drejtor të njësisë kryesore;
 - c) kutia e votimit për përgjegjës të njësisë bazë/qendër e kërkimit shkencor;
 - ç) kutia e votimit për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik i njësisë kryesore;
 - d) kutia e votimit për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve;
 - e) kutitë e votimit për Komisionet e përhershme
 - f) libri i protokollit të mbledhjeve të KZF-së;
 - g) tabelat për rezultatin e zgjedhjeve për secilën kategori;
 - h) dhomat e fshehta;
 - i) vulat me kodet e sigurisë.

KREU VI VOTIMI

Neni 33

Veprimet paraprake për hapjen e Qendrës së Votimit

1. KZF nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit dhe në praninë e vëzhguesve, një orë përpara hapjes së Qendrës së Votimit, kryen këto detyra:
 - a) vendos tryezat, karriget, dhomën e fshehtë dhe kutitë e votimit në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit, por edhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;
 - b) afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm, brenda Qendrës së Votimit;
 - c) afishon tabelat që ndalojnë përdorimin e çdo objekti që cenon fshehtësinë e votës;
 - d) kontrollon të gjitha materialet e marra në dorëzim;



e) u tregon vëzhguesve kutitë e votimit të zbrazëta – në faqen e përparme të çdo kutie votimi vendoset emertimi për autoritetin që do të votohet, me ngjyre të njejte me atë të fletës përkatëse të votimit;

f) mbyll kutitë e votimit me kodet e sigurisë dhe i shkruan këto kode në procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit dhe në librin e protokollit të mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Procesverbali mbyllet në zarfin ku është shkruar “Zarfi i procesverbalit të vulosjes”, i cili futet në kutinë e votimit për rektor, para fillimit të procesit të votimit;

g) sigurohet që në ambientet zgjedhore të mos ketë persona dhe shenja që cenojnë parimin e paanshmërisë dhe drejtësisë në procesin zgjedhor.

2. Anëtarët e KZF-së, në prani të kandidatëve e vëzhguesve të akredituar nga KIZ-i, në rast se paraqiten, marrin vendim për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.

3. Të njëjtat veprime kryhen edhe nga KQV-ja në rastet kur në njësinë kryesore votimi kryhet në më shumë se një qendër votimi.

Neni 34

Procedurat e votimit

1. Votimet për autoritetet drejtuese të të gjitha niveleve dhe Senatit Akademik në UV zhvillohen në të njëjtën ditë, në datën e caktuar nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për proceset zgjedhore të radhës.

2. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në këtë rregullore, kryetari i KZF-së/KQV-së deklaron hapjen e votimit, jo më përpara se ora 08:00.

3. Sekretari shënon në librin e protokollit të KZF-së/KQV-së kohën e largimit dhe të kthimit të çdo anëtari të komisionit prej qendrës së votimit.

4. Fletët e votimit vulosen në pjesën e pasme, majtas lart, me vulën e KZF-së, e cila mban respektivisht shkrimin “KZF” dhe emrin e njësisë kryesore/njësisë bazë.

5. Në Qendrën e Votimit vendosen 3 (tre) kuti votimi të veçanta për secilin autoritet drejtues (rektor / drejtues i njësisë kryesore / drejtues i njësisë bazë) për të cilët kryhet votimi në njësinë kryesore të UV-së dhe 2 (dy) kuti për Senatit Akademik nga të cilat 1 (një) për anëtarët e Senatit nga personeli akademik dhe 1 (një) për anëtarët e Senatit përfaqësues të studentëve.

6. Në mjediset e njësisë kryesore, ku kryhet procesi i votimit ndalohet rreptësisht çdo lloj forme fushate zgjedhore për kandidatët konkurrentë.

7. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë Qendrës së Votimit dhe futen njëri pas tjetrit në Qendrën e Votimit për të votuar, me thirrjen e një anëtari të komisionit. Pasi hyn në Qendrën e Votimit:

a) zgjedhësi paraqet para Komisionit të Qendrës së Votimit (KQV) një nga dokumentet zyrtare të vlefshme për identifikimin e tij:

i. pasaportë,

ii. kartë identiteti,

b) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identifikimit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën përfundimtare të zgjedhësve, të vulosur nga KIZ-i, shënon në listën e zgjedhësve



llojin dhe numrin personal të dokumentit të identifikimit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këto liste;

c) zgjedhësi që është pajisur nga KIZ-i me vendim për të votuar, pasi hyn në qendër e paraqet atë të kryetari i qendrës. Emri i këtij zgjedhësi dhe numri personal i mjetit të tij të identifikimit shënohet në një regjistër të veçantë;

d) zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;

e) zgjedhësit, personel i stafit akademik, i jepen për të votuar fleta e votimit për rektor, fleta e votimit për anëtar të personelit akademik në Senatit Akademik, fleta për drejtues të njësisë kryesore dhe fleta për përgjegjës departamenti/qendre kërkimore shkencore në të cilën bën pjesë;

f) zgjedhësit student i jepet për të votuar fleta e votimit për rektor, fleta për drejtues të njësisë kryesore dhe fleta për anëtar në Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve;

g) çdo fletë votimi vuloset, majtas lart, me vulën e KZF-së/ KQV-së;

h) pasi merr fletët e votimit zgjedhësi hyn në dhomën e fshehtë dhe:

1. në fletën e votimit për rektor, për drejtues të njësisë kryesore dhe për drejtues të njësisë bazë shënon në krah të emrit të kandidatit vetëm një nga këto tri shenja “x”, “+”, “√”. Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri. Në rastin kur për autoritet drejtues konkurron vetëm një kandidat, zgjedhësi voton një nga alternativat e shkruara krahas emrit të kandidatit “Pro” ose “Kundër”;

2. në fletën e votimit për anëtar të Senatit Akademik shënon, në krah të emrave të kandidatëve vetëm një nga këto tri shenja “x”, “+”, “√”. Zgjedhësi duhet të shënojë jo më shumë emra sesa është numri i mandateve në Senatit Akademik që i përkasin njësisë kryesore përkatëse;

3. pasi bën shënimin në fletën e votimit, i palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët në kutitë përkatëse të votimit dhe largohet nga Qendra e Votimit.

i) Nëse shënimin në fletën e votimit ose, së paku, në një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i qendrës e merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët “E dëmtuar” dhe e fut atë në zarfin “Fletë votimi të dëmtuara”. Në këtë rast zgjedhësit i jepet një fletëvotimi tjetër, e të njëjtit lloj, dhe rasti mbahet shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin “Fletë votimi të dëmtuara” dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletëvotimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet “e dëmtuar” dhe futet në zarfin “Fletë votimi të dëmtuara” dhe zgjedhësit i jepet një fletëvotimi e dytë. Rasti mbahet shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon ose e dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin “Fletë votimi të demtuara” dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara dhe të pavlefshme nuk hidhen në kutitë e votimit.

j) Qendra e Votimit organizohet në një mënyrë të tillë që ta lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtësinë e votës. Në Qendrën e Votimit është i ndaluar



përdorimi i mjeteve të komunikimit ose regjistrimit nga ana e votuesit. Në Qendrën e votimit mund të qendrojnë vetëm:

1. anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së;
2. zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit, deri në përfundim të tyre;
3. vëzhguesit e akredituar.

Neni 35 **Mbyllja e votimit**

1. Qendrat e votimit mbyllën në orën e caktuar. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, komisioni mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë, nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit.
2. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit. Pas kësaj, në Qendrën e Votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së, kandidatët, si dhe vëzhguesit e akredituar nga KIZ-i.

Neni 36 **Veprimet pas mbylljes së Qendrës së Votimit**

1. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari së bashku me anëtarët e KZF/KQV-së kryejnë sipas radhës, veprimet e mëposhtme:
2. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve :
 - a) shënon numrin e zgjedhësve që kanë votuar nga personeli i stafit akademik dhe studentët, duke numëruar nënshkrimet e bëra në listën përkatëse të zgjedhësve, si dhe të atyre që janë në regjistrin e veçantë, e që kanë votuar sipas kushteve të parshikuara në këtë rregullore.
 - b) ua deklaron shifrat me zë të lartë anëtarëve të tjerë të komisionit dhe vëzhguesve të pranishëm;
 - c) i fton ata të verifikojnë shifrat e thëna prej tij;
 - d) urdhëron sekretarin e komisionit të shënojë në procesverbalin për "Mbylljen e votimit" numrin e personave që kanë votuar në Qendrën e Votimit. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal.
3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve, pasqyron në procesverbalin për "Mbylljen e votimit" numrin e plotë të fletëve të votimit të Qendrës së Votimit, për secilën prej kategorive, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit nga KIZ-i, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara për secilën kategori.
4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura për secilën prej kategorive dhe, në përfundim të numërimit, ua bën të ditura shifrat anëtarëve të komisionit. Nëse kërkohet nga një anëtar i komisionit



ose ndonjë nga vëzhguesit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të papërdorura. Në përfundim të numërimit fletet e votimit të papërdorura mbyllet në zarfin ku është shënuar “Fletë votimi të papërdorura” për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në procesverbalin për “Mbylljen e votimit”.

5. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin “Fletë votimi të dëmtuara” për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në procesverbalin për “Mbylljen e votimit”.

6. Në përfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, futen:

a) në kutinë e materialeve zgjedhore për zgjedhjen e rektorit:

1. zarfi “Fletë votimi të papërdorura për zgjedhjen e rektorit”;

2. zarfi “Fletë votimi të dëmtuara për zgjedhjen e rektorit”;

3. procesverbali për numrin e fletëve të votimit gjithsej, numrin e fletëve të papërdorura

dhe numrin e fletëve të dëmtuara.

b) Për secilën kategori vepohet në të njëjtën mënyrë.

7. Mbyllet kutia e votimit. Elementet e sigurisë për mbylljen e këtyre kutive shënohen në procesverbal.

8. Kutia e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore përkatëse dërgohet në KIZ, brenda 24 orëve nga mbyllja e procesit të votimit. Kutitë shoqërohen nga dy anëtarë të KZF-së dhe mund të shoqërohen nga vëzhguesit e kandidatëve.

9. Në rastin kur në njësinë kryesore votimi është kryer në më shumë se një qendër votimi, Komisioni i Qendrës së Votimit pas administrimit të materialeve zgjedhore, sipas rregullave të përcaktuara në këtë nen, i dorëzon ato së bashku me kutinë e votimit për rektor në KZF, i cili është përgjegjës për transportin e tyre në KIZ.

Neni 37

Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit për zgjedhjen e rektorit, për anëtar në Senatin Akademik, autoritetit drejtues në njësitë kryesore, autoritetit drejtues në njësitë bazë

1. Procedurat për vlerësimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultatit për zgjedhjen e rektorit, autoritetit drejtues në njësitë kryesore, autoritetit drejtues në njësitë bazë, për anëtar në Senatin Akademik kryhen prej KZF-së, në vendin e numërimit të votave, që ndodhet në mjediset e njësisë kryesore.

2. Në rastin kur procesi i votimit është kryer në më shumë se një qendër votimi në njësinë kryesore, Komisioni i Qendrës së Votimit, pasi ka përfunduar administrimin e materialeve zgjedhore, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, ia dorëzon ato në vendin e numërimit të votave, KZF-së. Dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe i kutive të votimit bëhet me procesverbal.

3. Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultateve zhvillohet sipas radhës së mëposhtme:

a) rektor;

b) drejtues i njësisë kryesore;



- c) drejtues i njësisë bazë;
- d) anëtarë të Senatit Akademik (personel akademik dhe studentë).
- e) Anëtarë të Komisioneve të përhershme në njësitë kryesore (personel akademik dhe studentë).
4. Kryetari hap kutinë e votave për rektor, nxjerr nga kutia fletët e votimit, i shpalos dhe i vendos mbi tryezë, me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Pas kësaj:
- a) vlerëson të gjitha votat e gjetura në kuti, duke ua treguar të gjithë anëtarëve të komisionit dhe vëzhguesve. Votat e pavlefshme ndahen në një grup të veçantë;
- b) numëron votat e vlefshme dhe votat e pavlefshme. Numri i tyre, së bashku me numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti shënohen në procesverbal;
- c) verifikon numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti me numrin e votave që duhet të ishin në kuti, në bazë të të dhënave të procesverbalit të KZF/KQV-së për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit, fletët e votimit të papërdorura dhe fletët e votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbal;
- d) ndan në grupe të veçanta votat e hedhura nga personeli akademik dhe nga studentët dhe numëron votat e secilit grup. Numri i tyre shënohet në procesverbal;
- e) ndan votat e personelit akademik në grupe sipas emrit të kandidatit dhe i numëron. Votat e gjetura shënohen në procesverbal;
- f) ndan votat e studentëve në grupe sipas emrit të kandidatit dhe i numëron. Votat e gjetura shënohen në procesverbal;
- g) harton tabelën përfundimtare për votimin në njësinë kryesore përkatëse dhe e miraton me vendim.
5. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:
- a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KIZ-i;
- b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në këtë rregullore;
- c) në fletën e votimit janë bërë shënime ose shenja të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë rregullore;
- d) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
- e) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit për autoritetet drejtuese;
- f) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët në fletën e votimit;
- g) nuk është e qartë se për kë është votuar ose zgjedhësi ka votuar për një person ose subjekt që nuk është në fletën e votimit.
6. Në rast se në njësinë kryesore është votuar në më shumë se një qendër votimi, KZF-ja vlerëson dhe numëron votat për secilën qendër votimi, sipas procedurës së përkrahur më sipër.
7. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave për rektor, KZF-ja harton tabelën e rezultatit të votave për rektor. Kopje e tabelës së rezultatit të votave për rektor u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve dhe vëzhguesve.



8. Në rastin kur nuk ka asnjë fitues, KIZ-i, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje, merr vendim për organizimin dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve.
9. KZF-ja vazhdon procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, për anëtarët e Senatit Akademik.
10. Anëtarët e KZF-së, në rast mosdakordësie, gjatë numërimit të votave, referuar rasteve të fletëvotimeve të diskutueshme, marrin vendimin mbi to me shumicë të thjeshtë votash. Kjo zgjidhje e përjashton kategorikisht bllokimin e procesit zgjedhor.
11. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, KZF-ja harton tabelën përfundimtare të rezultateve të votimit dhe shpall me vendim të veçantë rezultatet për secilën kategori. Tabela përfundimtare dhe vendimi i KZF-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët duke deklaruar votën “Pro” ose “Kundër” dhe vulosen nga sekretari. Kopje e tabelës përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve u jepet, sipas kërkesës, vëzhguesve të kandidatëve.
12. Mënyra e përlllogaritjes së votave për autoritetet drejtuese për të cilat votojnë dhe studentët, do të jetë:
- $$R\% = (A/N1) * 90\% + (B/N2) * 10\%$$
- N1 N2
- R% - është rezultati i shprehur në përqindje i një kandidati për një pozicion të caktuar;
 A – është numri i votave pro kandidatit nga personeli akademik;
 N1 – është numri i përgjithshëm i votave të vlefshme nga personeli akademik;
 B – është numri i votave pro kandidatit nga studentët;
 N2 – është numri i përgjithshëm i votave të vlefshme nga studentët.
13. Vendimet e KZF-së për tabelat e rezultateve të zgjedhjeve ankimohen në KIZ.
14. Gjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave në vendin e numërimit të votave kanë të drejtë të qëndrojnë anëtarët dhe sekretari i KZF-së, kandidatët dhe vëzhguesit e tyre të akredituar nga KIZ-i.
15. Çdo kontestim i kandidatëve ose i vëzhguesve të tyre, shënohet detyrimisht në librin e procesverbaleve nga sekretari i KZF-së.

Neni 38 Ankimet

1. Çdo kandidat pjesëmarrës në zgjedhjet për autoritetet drejtuese ose anëtar në Senatit Akademik të UV-së ka të drejtë të ankohet në KIZ kundër vendimeve të KZF-së që cenojnë interesat e tij, brenda dy ditëve kalendarike, nga data e shpalljes së vendimit.
2. Kundër vendimeve të KZF-së për shpalljen e tabelave të rezultatit, tabelave përmbledhëse të rezultatit dhe rezultatit të zgjedhjeve, ankimi bëhet në KIZ, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e shpalljes së tyre.
3. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha dyditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimi dhe përfundon në orën 16:00, pas dy ditëve kalendarike.
4. KIZ-i administron dhe merr vendim për ankimet për çështje që nuk lidhen me rezultatit të zgjedhjeve, jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së tyre.



5. KIZ-i administron dhe merr vendime për ankimet për rezultatin e zgjedhjeve, jo me vonë se 48 ore pas paraqitjes së tyre.
6. Çdo vendim i KIZ-it është i ankimueshëm në Komisionin e Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit. Komisioni i Apelit shprehet me vendim të arsyetuar brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike.

Neni 39

Komisioni i Apelit

1. Komisioni i Apelit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët vetëkandidohen nga njësitë kryesore dhe zgjidhen nga Senati Akademik. Fitues shpallen kandidatët me numrin më të madh të votave sipas kësaj ndarjeje.
2. Për formimin e tij, Senati Akademik i UV-së, pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, publikon kërkesën për aplikim për anëtar në Komisionin e Apelit të institucionit, në një ditë me atë të KIZ-it. Të drejtën për të aplikuar e kanë individët që:
 - a) kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 (pesë) vjet me kohë të plotë;
 - b) nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
3. Komisioni i zgjedhur i Apelit, në mbledhjen e parë zgjedh kryetarin dhe sekretarin e tij, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve.
4. Anëtarët e Komisionit të Apelit kanë një mandat 4-vjeçar.
5. Në rastin e largimit të një anëtari nga ky komision, zëvendësimi i tij kryhet sipas pikës 1 të këtij neni.
6. Rregullat për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Apelit hartohen dhe vendosen prej këtij komisioni, menjëherë pas konstituimit të tij dhe zgjedhjes së kryetarit e sekretarit.
7. Anëtarët e Komisionit të Apelit shpërblehen për punën që bëjnë. Masa dhe mënyra e shpërblimit të tyre caktohet me vendim të Bordit të Administrimit të UV-së.
8. Komisioni i Apelit shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen dhe mendimet "kundër", për çdo ankim për vendime të marra prej KIZ-it.
9. Vendimi i Komisionit të Apelit është i formës së prerë, përfundimtar, i detyrueshëm për t'u zbatuar.
10. Kundër vendimeve të Komisionit të Apelit mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore nga pala që ka interes të ligjshëm.

Neni 40

Pavlefshmëria e zgjedhjeve

1. KIZ-i, kryesisht ose me kërkesë të kandidatëve, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë njësi kryesore, në rast se:
 - a) kanë ndodhur shkelje të ligjit dhe të kësaj rregulloreje që e kanë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve;



- b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të atilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim;
- c) votimi nuk ka filluar ose është pezulluar për më shumë se 5 (pesë) orë.
2. Kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve kërkuesi duhet ta shoqërojë me shpjegimin për shkaqet ligjore ku mbështetet kërkesa, përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe arsyetimin e detajuar të tyre për pasojat që kanë prodhuar.
3. Shqyrtimi i kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe vendimmarrja për kërkesën, bëhet nga KIZ-i, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga depozitimi i saj.
4. Vendimi i KIZ-it është i ankimueshëm në Komisionin e Apelimit, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.
5. Pas vendimit për pavlefshmëri të zgjedhjeve, shpallen zgjedhje të reja, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015 dhe kësaj rregulloreje.

Neni 41

Dispozita të fundit

1. Me përfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimeve në Komisionin e Apelimit, KIZ-i shpall rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të UV-së, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
2. KIZ-i i përcjell ministrin të Arsimit dhe Sportit, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultatit, vendimin për shpalljen e fituesit rektor të UV-së. Ministri i Arsimit dhe Sporteve, pas verifikimit të ligjshmërisë së procesit zgjedhor, i përcjell Presidentit të Republikës vendimin e KIZ-it për shpalljen e fituesit rektor të UV-së.
3. Mbledhja e parë e Senatit Akademik të UV-së mbahet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dekretimi i rektorit prej Presidentit të Republikës.
4. Rektori i zgjedhur dhe i dekretuar, emëron drejtuesit e zgjedhur të njësive kryesore të UV-së, brenda 7 ditëve nga dekretimi i tij.
5. Drejtuesi i njësive kryesore emëron drejtuesit e zgjedhur të njësive bazë brenda 7 (shtatë) ditëve të emërimit të tij.
6. I gjithë dokumentacioni zgjedhor ruhet në arkivin e institucionit, në bazë të rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
7. Monitorimi i procesit zgjedhor në të gjitha komisionet zgjedhore ose qendrat e votimit, realizohet nga kandidatët dhe vëzhguesit e akredituar.
8. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë nga të gjitha njësitë kryesore të UV-së.
9. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Senati Akademik i UV-së.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.ASOC. XHILIOLA AGARAJ(SHEHU)

